



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategoritë e ndryshme ekonomike në vlerë 2,289,103€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Rahovecit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe mos regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim
- A2 Komuna kishte lidhur kontrata me operatorët ekonomik për projekte kapitale në mungesë të fondeve buxhetore.
- B2 Vonesa në realizimin e punëve të kontraktuara.
- B3 Në 17 raste, faturat në vlerë totale prej 761,089€, kishte vonesa në pagesë prej 27 deri 376 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Rahovecit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Rahovecit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Rahovecit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohem ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Rahovecit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fusha që kërkon më shumë fokus për shkak të ndikimit në opinion të auditimit ka të bëjë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve. Ndërsa fushat tjera ku kemi identifikuar dobësi në kontrole ishin në menaxhimin e pasurive, kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve buxhetore, dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave, vonesave në pagesa si dhe vonesa në realizimin e punëve të kontraktuara.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe pesë (5) janë rekomandime të përsëritura.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat, duke përjashtuar kategorinë paga dhe shtesa.

Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,289,103€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbarimor të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e investimeve kapitale 1,424,349€, mallra dhe shërbime dhe komunal 718,087€ dhe nga subvencione dhe transfere 146,667€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe mos regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 11.3 pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim.

Gjatë auditimit kemi vërejtur që në tri (3) raste të pasurive të regjistruara si "Investime në vijim" në vlerë prej 132,242€, edhe pse projektet ishin përfunduar dhe ishin në përdorim dhe të njëjtat do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi, por ky proces nuk ishte përfunduar nga komuna.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive kapitale.

Ndikimi Mos mbyllja e investimeve në vijim ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurive kapitale në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare duke ndërmarrë veprime për përditësimin dhe mbylljen e investimeve në vijim duke prezantuar sakët dhe drejt vlerën e tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare

Gjetja Ligji i prokurimit publik Nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 përcakton se, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla". Po ashtu Ligji i Buxhetit nr. 08/L-332 për vitin 2025, neni 12 paragrafi 7 përcakton se; "Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim".

Kontraktimet e projekteve në mungesë të fondeve financiare janë identifikuar në këto raste si në vijim:

- Kontrata "Asfaltimi i rrugës Rahovec- Drenoc-Senoc-Pastasel-Polluzhë në vlerë totale të kontraktuar 3,863,124€. Në PIP për vitin 2025 dhe dy vitet vijuese janë paraparë fonde në vlerë 1,400,000€ ku

është lidhur memorandum i mirëkuptimit me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Nga kjo rezulton një mungesë e fondeve për realizimin e projektit për 2,463,124€.

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rreth rrotullimi “Rija” deri në dalje të rrugës Xërxë-Ritenderim në vlerë totale të kontraktuar 3,299,953€. Në PIP për vitin 2025 dhe dy vitet vijuese janë paraparë fonde në vlerë 1,022,193€, ndërsa përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Infrastrukturës të lidhur më 15/03/2021 janë siguruar 400,000€. Nga kjo rezulton një mungesë e fondeve për realizimin e projektit për 1,877,760€.
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci në Xërxë-Lot 1”, në vlerë të kontraktuar 7,886,582€ dhe “Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci në Xërxë-Lot 2”, në vlerë të kontraktuar 4,971,800 kishte të buxhetuar sipas ndarjeve buxhetore vetëm 6,042,920€, duke rezultuar me tejkalim të buxhetit për 6,815,462€.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi

Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrimi i kontratave përtej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare, rrit nevojën për ridestinime buxhetore për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve si dhe rrezikun e kostove shtesë.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të jenë në përputhje me shumatat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Vonesa në realizimin e punëve të kontraktuara

Gjetja

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik neni 70.23 thekson se përgjegjësi e menaxherit të projektit është të menaxhoj obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuar në kontratë dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, bën vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Ne identifikuam mangësi në menaxhimin dhe ekzekutimin e kontratave si në vijim:

- Projekti “Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe turizëm”, në vlerë prej 1,896,482 €, ishte nënshkruar më 05.10.2023 me afat ekzekutimi prej 480 ditësh. Megjithatë, ky projekt ende nuk ka përfunduar.
- Projekti “Ndërtimi i shkollës Hamez Thaçi”, në vlerë prej 1,575,678 €, ishte nënshkruar më 19.10.2022 dhe kishte afat ekzekutimi prej 480 ditësh. Megjithatë, as ky projekt nuk kishte përfunduar. (deri në kohën

sa ishim në auditim më 22.05.2026).

- Projekti “Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale në Komunën e Rahovecit”, në vlerë prej 518,437 €, ishte nënshkruar më 27.06.2023 dhe kishte afat ekzekutimi prej 480 ditësh, por ende nuk është përfunduar.(deri në kohën sa ishim në auditim më 22.05.2026).
- Projekti “Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit”, në vlerë prej 288,963 €, kishte kontratë të nënshkruar më 15.09.2021 me afat ekzekutimi prej 500 ditësh. Projekti ishte përfunduar më 20.05.2024, duke tejkaluar planin dinamik për 478 ditë.
- Projekti “Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve”, në vlerë prej 127,027 €, i nënshkruar më 12.10.2023 me afat ekzekutimi prej 480 ditësh, kishte tejkalim të afatit për 94 ditë dhe ishte përfunduar më 08.05.2025.

Vonesat në realizimin e punëve sipas menaxherëve të kontratave kanë qenë për shkak të kushteve atmosferike, mos zgjidhjes së problemeve pronësore, si dhe mos liferimit të pajisjeve me kohë. Por, është vërejtur se vonesat kanë ndodhur edhe si rezultat i mos planifikimeve reale, dhe planeve dinamike të mangëta për kryerjen e punimeve.

Ndikimi

Mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë tregon se planifikimet e afateve kohore, planet dinamike por edhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë. Si pasojë e mos realizimit me kohë të projekteve, qytetarët e komunës nuk i marrin shërbimet me kohë.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Vonesë në pagesat e faturave

Gjetja

Neni 39.1 i LMFPF-së përcakton se organizata buxhetore është përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 17 raste në vlerë totale 761,089€ nuk janë paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave kanë qenë nga 17 deri në 376 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjeteve të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e faturave mund ta bëjë komunën

subjekt të padive nga operatorët ekonomikë, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,747,310€, prej tyre në 2025 ishin shpenzuar 6,738,853€. Ato kanë të bëjnë me investime në infrastrukturën publike, përfshirë rrjetet e ujësjellësit, ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve, parqeve dhe hapësirave publike, ndërtimin e rrugësve.

Çështja B4 - Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave

Gjetja Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik nen 70.24 thekson se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin të prokurimit elektronik”.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të prokurimit kemi identifikuar se në pesë (5) kontrata të prokurimit publik, menaxherët e kontratave/projekteve nuk kishin bërë menaxhimin e implementimit të kontratave përmes modulit për menaxhimin e kontratave në platformën elektronike e-prokurimi.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi Mosrealizimi i menaxhimit dhe vlerësimit të performancës së kontraktuesve në sistemin elektronik dobëson kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave publike, si dhe mund të ndikojë në mungesë të informacionit të besueshëm për performancën e operatorëve ekonomikë për kontratat e ardhshme.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulën përkatëse në sistemin e prokurimit publik, si dhe të bëjnë vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomikë përmes moduleve përkatëse në sistemin elektronik të prokurimit, në përputhje me manualin përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Të arkëtueshmet

Në PVF për vitin 2025, komuna ka shpalosur llogaritë e arkëtueshme në vlerë 3,856,302€. Llogaritë e arkëtueshme kishin të bënë me tatimin në pronë, taksa për ushtrimin e veprimtarisë dhe qiraja për vendosjen e objektit tregtar.

Çështja B5 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas Ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 27 Njoftimi përfundimtar pika 27.1 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Në vitin 2025, totali i llogarive të arkëtueshme të komunës arriti në 3,856,302€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive i takon tatimit në pronë në vlerë prej 3,355,414€ (rreth 87%), taksës për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë prej 457,023€ (rreth 12%) dhe qirasë nga vendosja e objekteve tregtare në vlerë prej 43,865€ (rreth 1%).

Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2025 komuna kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e borxheve duke dërguar vërejtje dhe letërkujtesa tek borxhlinjtë, llogaritë e arkëtueshme në total krahasuar me vitin paraprak (2,653,115€), janë rritur për 1,203,186€, apo rreth 45%. Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek qiraja për vendosjen e objekteve tregtare.

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak që nuk janë ndërmarrë veprime ligjore për arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave ka ndikim negativ në nivelin e buxhetit, pasi krijon mungesë fondesh të mbledhura, duke penguar financimin dhe realizimin e projekteve komunale. Gjithashtu, kjo çon në vjetërsimin e këtyre llogarive, duke e bërë të pamundur arkëtimin e tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë procesit të auditimit ne i kemi pranuar draft PFV e Komunës së Rahovecit, dhe i kemi analizuar ku janë identifikuar çështje materiale të cilat pas sugjerimeve tona menaxhmenti i organizatës buxhetore i ka bërë korrigjimet në PFV finale.

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1

Gabimet e identifikuar në prezantimin e PFV

Gjetja

Gjatë rishikimit të pasqyrave financiare vjetore u identifikuan disa mospërputhje dhe prezantime jo të sakta si:

Te neni 13- Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - tek pjesa burimet e fondeve komuna nuk kishte prezantuar saktë kthimin e mjeteve prej 21,000€ tek pjesa pranimet tjera, kjo reflekton edhe tek totali i shpenzimeve tek kjo pjesë.

Po ashtu te neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - tek pjesa shfrytëzimi i fondeve - pagesat te shënimi 7 komuna ka prezantuar gabimisht vlerën e shpenzimeve kapitale 6,718,000€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit do të duhej të jetë 6,738,852€, kjo reflekton edhe totalin e shpenzimeve tek kjo pjesë si dhe shpalosjen e shpenzimeve kapitale.

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa hyrje e parasë së gatshme të shtylla buxheti realizimi (A) te shënimi 11 grandet e përcaktuar të donatoreve nuk është bërë raportimi i saktë pasi komuna ka prezantuar shumën 114,000€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit do të duhej të jetë 47,492€, kjo reflekton edhe tek shpalosja.

Po ashtu te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa hyra e parasë së gatshme të shtylla buxheti final (B) dhe rreshti te shënimi 11 Grandet e përcaktuara të donatoreve - Komuna duhet ti prezantoj vlerat e planifikuara për të gjitha marrëveshjet me donatorët për ti pranuar në vitin 2025.

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa dalja e parasë së gatshme te shtylla buxheti final (A)- realizimi shpenzimet kapitale komuna ka prezantuar gabimisht vlerën 6,720,000€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit do të duhej të jetë 6,738,852€, po ashtu te shënimi 7 tjera ka prezantuar vlerën 19,000€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit do të duhej të jetë 21,190€, kjo reflekton edhe tek totali i shpenzimeve.

Te neni 14.6 shpalosjet e ndarjeve fillestar dhe final të buxhetit te pjesa hyrjet të harmonizohet në bazë të ndryshimeve që bëhen tek dy tabelat e para.

Te shpalosjet neni 24 raporti për fondet e donatoreve të pashpenzuara komuna ka prezantuar si shpenzime prej donacioneve shumën 107,340€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit do të duhej të jetë 86,149€.

Veprimi i kërkuar Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për ti korrigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati Menaxhmenti kishte marrë veprime korrigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korrigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PFV e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	20,982,796	22,752,791	22,743,450	22,638,724	20,385,685
Grante Qeveritare - Buxheti	18,981,085	19,979,017	19,977,050	19,509,565	17,536,263
Të bartura nga viti i kaluar	0	679,543	678,791	586,483	482,531
Të hyrat vetanake	2,001,711	2,001,711	2,001,459	1,599,242	1,423,641
Donacionet vendore	0	634	575	0	0
Donacionet e jashtme	0	91,885	85,575	943,433	943,249

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,769,995€. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes nga Granti Qeveritar për 997,932€, të hyrave të bartura nga vitit i kaluar në vlerë 679,543€ si dhe donaconeve vendore dhe të jashtme për 92,519€.

Shkalla e realizimit të buxhetit final është 99% ose 22,743,450€, me realizim të ngjashëm me vitin e kaluar (2024-99%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	20,982,796	22,752,791	22,743,450	22,638,724	20,385,685
Pagat dhe mëditjet	10,746,449	11,744,381	11,743,650	11,750,201	9,985,339
Mallrat dhe shërbimet	2,761,006	2,811,100	2,810,955	2,545,794	2,279,307
Komunalitë	390,000	390,000	389,992	389,996	370,000
Subvencionet dhe transferet	1,010,000	1,060,000	1,060,000	960,402	833,859
Investimet Kapitale	6,075,341	6,747,310	6,738,853	6,992,331	6,917,179

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 997,932€. Kjo rritje është si rezultat i rritjes së pagave dhe vlerës së koeficientit të pagave. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99%;


Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 50,094€. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave vetanake të bartura si dhe donacioneve të ndryshme. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99%;

Buxheti final për kategorinë e komunalive krahasuar me atë fillestar nuk kishte ndryshuar. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99%;

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 50,000€. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave të bartura. Shpenzimi në këtë kategori ishte 100%;

Buxheti final për investimet kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 671,969€. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave të bartura dhe donacioneve të ndryshme. Shpenzimi për këtë kategori ishte 99%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e planifikuar për vitin 2025 ishin 2,001,711€, ndërsa janë realizuar 2,190,950€ apo 10% më shumë se plani. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2025 Komuna e Rahovecit ka përfutur të hyra nga gjobat në trafik, gjoba të gjykatave si dhe gjobave nga pyjet në vlerë totale prej 433,614€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	2,001,711	2,001,711	2,190,950	1,847,957	1,808,491
Të hyrat tatimore	701,443	701,443	1,051,813	993,629	1,040,765
Të hyrat jo tatimore	1,300,268	1,300,268	1,136,819	854,327	767,004
Të hyrat tjera	0	0	2,318		722

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 për Komunën e Rahovecit ka rezultuar në (gjashtë) 6 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna si dhe është dorëzuar raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, 1 rekomandim është zbatuar; 5 nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në lidhje me zbatimin e kërkesave të manualit/rregullores përkatëse, me rastin e subvencionimit të OJQ-ve.	Komuna kishte arritur ta implementoj këtë rekomandim.	I zbatuar
2.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.	Nuk ishin marrë hapa konkret për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranura paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit.	Përkundër rekomandimit të dhënë në vitin e kaluar, vonesa në pagesa të obligimeve nuk ishte implementuar.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.	Përkundër rekomandimit të dhënë në vitin paraprak, menaxhimi i kontratave nuk ishte bërë përmes e-prokurimit.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.	Përkundër përpjekjeve të bëra, rekomandimi nuk është implementuar ende.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për vendosjen e mekanizmave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshmeve.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Liridona Berisha Kelmendi, Udhëheqëse e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Valmira Jonuzi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare	Pika numer 3: Kontrata “Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci në Xërxë-Lot 1”, në vlerë të kontraktuar 7,886,582€ dhe “Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci në Xërxë-Lot 2”, në vlerë të kontraktuar 4,971,800€ kishte të buxhetuar sipas ndarjeve buxhetore vetëm 6,042,920€, duke rezultuar me tejkalim të buxhetit për 6,815,462€. Koment: Rruga rajonale, e njohur sipas emërimit zyrtar si rruga regjionale R-110, e cila përfshin segmentin Xërxë-Rahovec-Malishevë, është në kompetencë të nivelit qendror, përkatësisht të Ministrisë së Infrastrukturës. Vlerësojmë se përfshirja e Komunës në çështjen që lidhen me punimet në këtë rrugë përfshin, mbikëqyrjen e perbashket, ndersa monitorimin dhe financimin e kësaj rruge eshte e drejte ekzkluzive e Ministrise. Sipas memorandumit, Komuna ka ushtruar vetëm rolin e menaxhimit dhe koordinimit të aktiviteteve lokale, ndërsa përgjegjësitë për mbikëqyrje, monitorim dhe financimin e ketij projekti i takojnë Ministrisë së Infrastrukturës. Për këtë arsye, konsiderojmë se çdo interpretim që bart këto përgjegjësi te niveli lokal nuk është në përputhje me kompetencat e përcaktuara në memorandum dhe me përgjegjësitë institucionale të palëve.	E gjetura e auditorit qëndron. Komuna ka qenë palë në memorandum dhe ka marrë rol në menaxhimin dhe koordinimin e projektit nuk e përjashton përgjegjësinë e saj për të siguruar që angazhimet kontraktuale dhe financiare të jenë në përputhje me ndarjet dhe kufizimet buxhetore të aprovuara. Për më tepër neni 3 i memorandumit të mirëkuptimit specifikon se pagesat bëhen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit deri në vlerën e financimit.
Vonesa në realizimin e punëve të kontraktuara	Pika numer 1: Projekti “Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe turizëm”, në vlerë prej 1,896,482 €,	E gjetura e auditorit qëndron. Komentet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues ofrojnë sqarime lidhur

ishite nënshkruar më 05.10.2023 me afat ekzekutimi prej 480 ditësh. Megjithatë, ky projekt ende nuk ka përfunduar. (deri në kohën sa ishim në auditim më 22.05.2026).

Koment: Sa i përket projektit tjetër, ju ofrojmë dëshmi se para auditimit tuaj, në datën e cekur në raport, ka ekzistuar vendimi për shkëputjen e kontratës me numër protokoli 1369 / i dates 01.04.2026 (te bashkangjitur keni dokumentin).

Ky vendim është nxjerrë para periudhës së auditimit dhe dëshmon se Komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative dhe ligjore në përputhje me kompetencat dhe obligimet e saj kontraktuale. Për rrjedhojë, konsiderojmë se ky fakt duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të gjetjes, pasi dëshmon se çështja ishte trajtuar dhe se veprimet përkatëse ishin ndërmarrë para auditimit.

Pika numer 5: Projekti “Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve”, në vlerë prej 127,027 €, i nënshkruar më 12.10.2023 me afat ekzekutimi prej 480 ditësh, kishte tejkalim të afatit për 94 ditë dhe ishte përfunduar më 08.05.2025.

Koment: Sa i përket këtij projekti, duhet të sqarojmë se punimet janë përfunduar brenda afatit të paraparë kontraktual. Megjithatë, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, të cilat ishin planifikuar të barten, si dhe vonesave në bartjen e fondeve nga niveli qendror, Komuna ka vendosur të mos pranojë fatura në pritje pa pasur mbulimin e nevojshëm buxhetor.

Kjo ka qenë arsyeja kryesore e mosfinalizimit financiar të projektit në periudhën përkatëse. Për të dëshmuar gjendjen faktike, ju ofrojmë dokumentacionin përkatës që vërteton se projekti tashmë është përmbyllur plotësisht, si në aspektin e realizimit të punimeve ashtu edhe në aspektin financiar, pas pranimit të mjeteve nga kodi 22.

Prandaj, konsiderojmë se çështja është trajtuar dhe mbyllur në tërësi,

me rrethanat që kanë ndikuar në realizimin e projekteve, siç janë mungesa e mjeteve financiare, vonesat në bartjen e fondeve, kushtet operative, kushtet atmosferike, si dhe ndërmarrja e veprimeve administrative për menaxhimin e kontratave. Megjithatë, këto sqarime nuk e ndryshojnë faktin e konstatuar në auditim se projektet nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara kontraktuale. Për rrjedhojë, komentet e paraqitura shpjegojnë arsyet e vonesave, por nuk e kundërshtojnë gjetjen e auditimit lidhur me mosrealizimin e projekteve në përputhje me afatet e përcaktuara në kontrata.

ndërsa obligimet financiare janë kryer menjëherë pas sigurimit të fondeve të nevojshme.

Gjetja: Projekti “Ndërtimi i shkollës Hamez Thaçi”, në vlerë prej 1,575,678 €, ishte nënshkruar më 19.10.2022 dhe kishte afat ekzekutimi prej 480 ditësh.

Megjithatë, as ky projekt nuk kishte përfunduar. (deri në kohën sa ishim në auditim më 22.05.2026).

Komenti: Për projektin “Ndërtimi i Shkollës Fillore Hamëz Thaqi”, vonesat në realizimin e punimeve kanë ardhur si rezultat i disa faktorëve objektivë që kanë ndikuar në dinamikën e zbatimit të kontratës. Një nga arsyt kryesore ka qenë mungesa e mjeteve të mjaftueshme buxhetore gjatë periudhave të caktuara, për shkak se një pjesë e mjeteve nga kodi buxhetor përkatës janë tërhequr nga Thesari për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive. Kjo ka ndikuar në realizimin e pagesave sipas planifikimit dhe rrjedhimisht në vazhdimësinë e punimeve nga operatori ekonomik.

Po ashtu, realizimi i projektit është ndikuar edhe nga faktorë të tjerë, përfshirë dinamikën e kryerjes së punimeve në terren, kushtet atmosferike në periudha të caktuara dhe nevojën për koordinim të aktiviteteve teknike gjatë zbatimit të projektit.

Autoriteti Kontraktues ka monitoruar vazhdimisht ecurinë e kontratës dhe ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për sigurimin e mjeteve financiare dhe vazhdimin e punimeve.

Aktualisht projekti është në realizim e sipër dhe nuk ka përfunduar ende, ndërsa po vazhdojnë aktivitetet për përmbylljen e tij në përputhje me kushtet e kontratës dhe mundësitë buxhetore në dispozicion.

Vonesat nuk kanë ardhur si pasojë e mosveprimit të Autoritetit Kontraktues, por si rezultat i rrethanave financiare dhe operative që kanë ndikuar në realizimin e projektit.

Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të prokurimit kemi identifikuar se në pesë (5) kontrata të prokurimit publik, menaxherët e kontratave/projekteve nuk kishin bërë menaxhimin e implementimit të kontratave përmes modulit për menaxhimin e kontratave në platformën elektronike e-prokurimi. Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre. Koment: Sipas Nenit 70 Dispozitat e përgjithshme Bartja e përgjegjësisë të Menaxheri i Kontratës sipas paragrafit 70.5 Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA). Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në bashkëpunim me Njësinë e Kërkesës do t'i propozojë ZKA-së një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, nëse aplikohet, të cilët do të kenë përgjegjësi si në paragrafët 70.23-25. ZKA me vendim do ta emërojë Menaxherin e Kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës. Paragrafi 70.6 Zyrtari i prokurimit, menaxherin e kontratës (për vlerë të vogël, të mesme dhe vlerë të madhe) dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë (vlerë të mesme dhe vlerë të madhe) të emëruar nga ZKA do t'i vendosë në hapat përkatës gjatë përgatitjes së njoftimit për nënshkrim të kontratës sipas nenit 21.8 të kësaj rregullore. Zyrtar të Komunës si Menaxher të Kontratave kanë pasur trajnime për Menaxhimin e Kontratës nga këshilltar të USAID-it, po ashtu disa zyrtar të tjerë kanë mbajtur trajnime në IKAP, dhe në Zyrë e Prokurimit kemi qenë çdo herë në gatishmëri për ndihmës për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të	E gjetura e auditorit qëndron. Komenti i paraqitur përshkruan procedurën e emërimit të menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe trajnimet dhe mbështetjen e ofruar për zyrtarët përgjegjës. Megjithatë, këto sqarime nuk e kundërshtojnë faktin e konstatuar në auditim se për pesë (5) kontrata nuk është përdorur moduli për menaxhimin e kontratave në platformën elektronike të e-prokurimit. Për rrjedhojë, komenti nuk ofron dëshmi që moduli është përdorur për kontratat e identifikuar dhe nuk e eliminon gjetjen e auditimit lidhur me moszbatimin e kërkesave për menaxhimin e kontratave përmes sistemit të e-prokurimit.
--	--	--

Kontratës.



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA RAHOVECI / OPŠTINA RAHOVAČ / MUNICIPALITY RAHOVEC
 KABINETI / KABINETI / KABINET
 Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
 Nr./Br./No. 7463 Nr. ifaq/Br.sht./No.pg. 49
 Data/Date/Date 10.06.26
 RAHOVEC / RAHOVAČ

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për
 zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Smajl Latifi

Zyrtar Kryesor Administrativ

Data: 10 Qershor 2026, Rahovec,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.